2. Paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 i Vendimit Bazë Sh.01 Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Në vend të anëtarit të Komisionit **z. Selami Klaiqi (DKA)**, caktohet anëtare e Komisionit **znj. Belgizare Kryeziu (Drejtoreshë e Shkollës "Metush Krasniqi", Rogaçicë)**.
3. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit Bazë Sh.01 Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës.
4. Bashkëngjitur këtij Vendimi është Vendimit Bazë Sh.01 Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës.
5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky Vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës – MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të internetit të Komunës.

Arsyetim

Me Vendimin Sh.01 Nr.21967, datë 12.08.2025, është formuar Komisioni për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës, në përbërje të të cilit është emëruar edhe z. Selami Klaiqi, i cili në atë kohë ushtronte detyrën e Drejtorit të Gjimnazit "Ismail Qemali" në Kamenicë.

Ndërkohë, z. Selami Klaiqi është emëruar në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit. Duke marrë parasysh se Rregullorja (QRK) Nr. 19/2024 përcakton përbërjen e Komisionit dhe nuk parasheh që Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit të jetë pjesë e këtij komisioni, është e nevojshme që ai të lirohet nga detyra e anëtarit të Komisionit dhe të zëvendësohet në përputhje me dispozitat në fuqi.

Për këtë arsye propozohet ndryshimi i nënparagrafit 2.2 të Vendimit Bazë dhe zëvendësimi i tij me anëtarin e re të Komisionit, me qëllim të sigurimit të funksionimit të rregullt dhe të pandërprerë të Komisionit.

Vendimi i'u dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë Komunale të Arsimit, MAPL-së, QSHQ-Arkivit.

Kryesuesi e Kuvendit Komunal

Arbnore BEQIRAJ FERA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra e Kryetarit



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Në mbështetje të nenit 5, shkronja b), neneve 11, 13, 14 dhe 17, shkronjat a) dhe c), si dhe nenit 58, shkronja h), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), të nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të nenit 17, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe të nenit 3, paragrafi 3.7, nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja h), nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h), dhe nenit 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal të Komunës së Kamenicës, e cila mbahet më _____ 2026, sjell këtë:

**PROPOZIM VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE DHE
VLERËSIMIN E OFERTAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

1. Me këtë vendim formohet Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës përmes procedurës së shprehjes së interesit, për pronën në Zonën Kadastrale Kamenicë, e evidentuar sipas Certifikatës së Pronësisë P-71107041-02071-2.
2. Komisioni, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si në vijim:
 - 2.1. _____, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.2. _____, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.3. _____, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës;
 - 2.4. _____, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës;
 - 2.5. _____, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Komisioni ka për detyrë të zbatojë procedurën e konkurrimit të hapur dhe të bëjë vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, në kohëzgjatje prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjetësh, të pronës së paluajtshme të Komunës. Në kuadër të këtyre detyrave, Komisioni përgatit dhe publikon njoftimin publik për shprehjen e interesit, i cili përmban: emrin, përshkrimin, sipërfaqen, destinimin dhe lokacionin e pronës që jepet në shfrytëzim, afatin e dhënies në shfrytëzim, veprimtarinë që mund të ushtrohet, afatin e fundit për aplikim, vendin e pranimit të ofertave për shprehjen e interesit, si dhe informacionet e tjera të nevojshme.

4. Komisioni obligohet që gjatë ushtrimit të detyrave të tij të veprojë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
5. Administrata e Komunës i ofron Komisionit mbështetjen administrative dhe profesionale të nevojshme për realizimin e detyrave të përcaktuara me këtë vendim.
6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Komisioni, sipas pikës 2 të këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe QSHQ – arkivit.


Kryetar i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kancelarija Predsednika

Na osnovu člana 5, slova b), članaka 11, 13, 14 i 17, slova a) i c), kao i člana 58, slova h), Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br. 03/L-040 ("Službeni List Republike Kosovo", Br. 28/2008), član 17 Zakona za Davanje na Korišćenje i Razmena Opštinske Nepokretne Imovine Br. 06/L-092, člana 17, stav 1 i 2 Uredbe (VRK) za Utvrđivanje Postupaka za Davanje na Korišćenje i Razmena Opštinske Nepokretne Imovine Br. 09/2020, kao i člana 3, stav 3.7, člana 5, stav 5.1, slova h), član 70, stav 70.1, slova h), i člana 82 Statuta Opštine Kamenica Š 01, Br. 20203, od/datum 21.06.2023, Predsednik Opštine, za redovnu sednicu Skupštine Opštine Kamenica koja će se održati dana _____ 2026, donosi ovu:

PREDLOG ODLUKE

O FORMIRANJU KOMISIJE ZA SPROVOĐENJE POSTUPAKA I VREDNOVANJE PONUDA ZA DAVANJE NA KORIŠĆENJE OPŠTINSKE NEPOKRETNE IMOVINE

1. Ovom odlukom formirana Komisija za sprovođenje postupaka za vrednovanje ponuda za davanje na dugoročno korišćenje Opštinske nepokretne imovine putem postupaka izražavanja interesovanja, za imovinu na Katastarskoj Zoni Kamenica, evidentovano prema Imovinskom Uverenju P-71107041-02071-2.
2. Komisija, prema tački 1 ove odluke, sastavljena od 5 (pet) sledećih članova:
 - 2.1. _____, predstavnik iz Opštinske Izvršne Vlasti;
 - 2.2. _____, predstavnik iz Opštinske Izvršne Vlasti;
 - 2.3. _____, predstavnik iz Skupštine Opštine;
 - 2.4. _____, predstavnik iz Skupštine Opštine;
 - 2.5. _____, predstavnik iz nevladin sektor.
3. Komisija je dužna da sprovede postupak otvorenog konkurisanja i napravi vrednovanje ponude za davanje na dugoročno korišćenje, u trajanju od 99 (devetdeset devet) godina, Opštinske nepokretne imovine. U okviru ovih zadataka, Komisija priprema i objavljuje obaveštenje za izražavanje interesovanja, koje sadrži: ime, opis, površinu, destinaciju i lokaciju imovine koja se daje na korišćenje, rok davanja na korišćenje, delatnost koja se može obavljati, poslednji rok za prijavu, mesto prijema ponuda za izražavanje interesovanja, kao i druge neophodne informacije.
4. Komisija je dužna da tokom obavljanja njenih dužnosti, postupi u skladu sa odredbama Zakona za Davanje na Korišćenje i Razmena Opštinske Nepokretne Imovine, Br. 06/L-092,

kao i Uredbe (VRK), za Utvrđivanje Postupaka za Davanje na Korišćenje i Razmena Opštinske Nepokretne Imovine Br. 09/2020.

5. Opštinska Administracija Komisiji pruža administrativnu i profesionalnu podršku potrebnu za realizaciju utvrđenih zadataka ovom odlukom.
6. O sprovođenju ove odluke brine Komisija, kao u tački 2 ove odluke.
7. Ova odluka stupa na snagu trideset (30) dana nakon slanja kod nadzornog organa, u skladu sa Zakonom za Administrativno Razmatranje Opštinskih Akata Br. 08/L-284 i Uredbe (VRK) o Postupku Administrativnog Razmatranja Opštinskih Akata Br. 02/2026, i sedam (7) dana nakon objavljivanja na oglasnoj tabli i na službenoj veb stranici Opštine Kamenica.

Odluku uručiti: Kancelariji Predsednika, Kancelariji Informisanja, Kancelariji Prevođenja, Odeljenju Imovine, Katastar i Geodeziju, Odeljenju Urbanizma i Prostornog Planiranja, i GUCO-e – arhivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Duke u bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenin 53, paragrafët 1 dhe 3 dhe nenit 84 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 20/2016), nenin 12, paragrafi 2 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, si dhe në mbështetje të nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h), dhe nenit 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, në bazë të kërkesave për rishqyrtimin e akteve të lëshuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me numrat e protokollit 020-402/11, 020-402/12, 020-402/13 dhe 020-402/14, të datës 16.07.2026, Kryetari i Komunës së Kamenicës, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës që mbahet më _____ 2026, propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shfuqizimin e vendimeve Sh.01.Nr.15152, Sh.01.Nr.15160, Sh.01.Nr.15161 dhe Sh.01.Nr.15156, të datës 05.06.2026

1. Shfuqizohet Vendimi Sh.01.Nr.15152, i datës 05.06.2026, për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
2. Shfuqizohet Vendimi Sh.01.Nr.15160, i datës 05.06.2026, për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
3. Shfuqizohet Vendimi Sh.01.Nr.15161, i datës 05.06.2026, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
4. Shfuqizohet Vendimi Sh.01.Nr.15156, i datës 05.06.2026, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë Vendimi Sh.01.Nr.15152, i datës 05.06.2026, Vendimi Sh.01.Nr.15160, i datës 05.06.2026, Vendimi Sh.01.Nr.15161, i datës 05.06.2026, Vendimi Sh.01.Nr.15156, i datës 05.06.2026, si dhe kërkesat për rishqyrtimin e akteve të lëshuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me numrat e protokollit 020-402/11, 020-402/12, 020-402/13 dhe 020-402/14, të datës 16.07.2026.

6. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në përputhje me nenin 8, lidhur me nenin 9, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 24/2024), si dhe nenin 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Nënkryetares, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve dhe QSHQ- arkivit.



Kryetar i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kancelarija Predsednika

Na osnovu člana 13 i 58 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br. 03/L-040 ("Službeni List Republike Kosovo", Br. 28/2008), člana 53, stavova 1 i 3 i člana 84 Zakona o Opštem Upravnom Postupku Br. 05/L-031 ("Službeni List Republike Kosovo", Br. 20/2016), član 12, stav 2 Uredbe (MALS-a) o Postupcima za Izradu i Publikacije Opštinskih Akata, Br. 02/2021, kao i na osnovu člana 70, stav 70.1, slova h), i član 82 Statuta Opštine Kamenica Š 01, Br. 20203, od/datum 21.06.2023, na osnovu zahteva za ponovno razmatranje izdato od Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave, sa brojevima protokola 020-402/11, 020-402/12, 020-402/13 i 020-402/14, od/datum 16.07.2026, Predsednik Opštine Kamenica, za redovnu sednicu Skupštine Opštine koja će se održati dana _____ 2026, predlaže sledeće:

PREDLOG ODLUKE

Za stavljanje van snage sledeće odluke: Š 01, Br. 15152, Š 01, Br. 15160, Š 01, Br. 15161 i Š 01, Br. 15156, od/datum 05.06.2026

1. Stavlja se van snage Odluka Š 01, Br. 15152, od/datum 05.06.2026, o formiranju Komisije za sprovođenje postupaka i vrednovanje ponuda za davanje na korišćenje Opštinske nepokretne imovine.
2. Stavlja se van snage Odluka Š 01, Br. 15160, od/datum 05.06.2026, o formiranju Komisije za sprovođenje procedura i vrednovanje ponuda za davanje na korišćenje Opštinske nepokretne imovine.
3. Stavlja se van snage Odluka Š 01, Br. 15161, od/datum 05.06.2026, za davanje na krakoročno korišćenje Opštinske nepokretne imovine.
4. Stavlja se van snage Odluka Š 01, Br. 15156, od/datum 05.06.2026, za davanje na krakoročno korišćenje Opštinske nepokretne imovine.
5. Sastavni deo ove odluke su: Odluka Š 01, Br. 15152, od/datum 05.06.2026, Odluka Š 01, Br. 15160, od/datum 05.06.2026, Odluka Š 01, Br. 15161, od/datum 05.06.2026, Odluka Š 01, Br. 15156, od/datum 05.06.2026, kao i zahtevi za ponovno razmatranje akata izdato od Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave, sa brojevima protokola: 020-402/11, 020-402/12, 020-402/13 i 020-402/14, od/datum 16.07.2026.
6. Ova odluka stupa na snagu 30 (trideset) dana nakon slanja nadzornom telu, u skladu sa članom 8, a u vezi sa članom 9, Zakona za Administrativno Razmatranje Akata u Opštinama

Br. 08/L-284 ("Službeni Liste Republike Kosovo", Br. 24/2024), kao i člana 8, u vezi sa članom 9, Uredbe (VRK), o Postupcima za Administrativno Razmatranje Akata u Opštinama Br. 03/2026, i nakon javnog objavljivanja na oglasnoj tabli ili opštinskoj službenoj veb stranici.

Odluku dostaviti: Kancelariji Predsednika, Kancelariji Potpredsednice, Kancelariji Informisanja, Kancelariji Prevođenja i GUCO-e - arhivi.




Predsednik Opštine
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 05.06.2026



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING		
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO		
Opština Kamenica / Kamenica Municipality		
Dated: 08-06-2026		
Signature:	Mr. Lendës:	Mr. Lendës:
-01-020-402		

Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d), 14, 17, shkronja a) dhe neni 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), neni 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 17 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe neni 3, paragrafi 3.7, neni 5, paragrafi 5.1, shkronja h), neni 38, paragrafi 38.1 dhe neni 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 29.05.2026 miratoi këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

- Me këtë vendim formohet Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, për parcelat e evidentuara sipas certifikatave të pronësisë me numër P-71107041-01339-0 dhe P-71107041-01340-0, në pronësi të Komunës së Kamenicës, për një periudhë deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
- Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, si në vijim:
 - 2.1 Edon Dërmaku - përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës,
 - 2.2 Burbuqe Leka - përfaqësuese nga Ekzekutivi i Komunës,
 - 2.3 Leonita Mavriqi - përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës,
 - 2.4 Djellonë Rudhani - përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës,
 - 2.5 Albulena Gagica - përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës,
 - 2.6 Sherafedin Vranja - përfaqësues nga sektori joqeveritar.
- Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë shpallja e njoftimit publik për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, përcaktimi i çmimit fillestar, hartimi i kushteve dhe kritereve të ankandit publik, zhvillimi dhe administrimi i procedurave të ankandit publik, si dhe vlerësimi i ofertave në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Obligohen anëtarët e Komisionit që gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të tyre të veprojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

5. Obligohet Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave që, në bashkëpunim me administratën komunale, të zhvillojë procedurat e ankandit publik dhe procesin e vlerësimit të ofertave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Administrata e Komunës i ofron mbështetje administrative dhe profesionale Komisionit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.
7. Kuvendi i Komunës së Kamenicës ruan të drejtën e ndryshimit dhe plotësimit të përbërjes së Komisionit, sipas nevojës.
8. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Komisioni dhe organet përgjegjëse të administratës komunale.
9. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në pajtim me nenin 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 24/2024), si dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Nënkyetares, Shërbimit të Kuvendit, Drejtorive Komunale, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Anëtarëve të Komisionit, MAPL-së dhe QSHQ – arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Arbnor BEQIRAJ FERA

HYPERE - ULAZNA - INCOMING

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministère de l'Administration Locale
Ministry of Local Government Administration


Data
Date: 08.06.2026

Nr. i Lendës
No. of Pages: -VI- 020-402



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 05.06.2026



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d), 14, 17, shkronja a) dhe neni 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), neni 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 17 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe neni 3, paragrafi 3.7, neni 5, paragrafi 5.1, shkronja h), neni 38, paragrafi 38.1 dhe neni 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 29.05.2026 miratoi këtë:


VENDIM

Për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, parcelës me nr. P-71107041-01981-1, ZK Kamenicë, për periudhë deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
2. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, si në vijim:
 - 2.1. Edon Dërmaku - përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës,
 - 2.2. Burbuqe Leka- përfaqësuese nga Ekzekutivi i Komunës,
 - 2.3. Valmir Ramadani - përfaqësues nga Kuvendi i Komunës,
 - 2.4. Djellonë Rrudhani - përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës,
 - 2.5. Albulena Gagica - përfaqësuese nga Kuvendi i Komunës,
 - 2.6. Sherafedin Vranja - përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë shpallja e njoftimit publik për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, përcaktimi i çmimit fillestar, hartimi i kushteve dhe kritereve të ankandit publik, zhvillimi dhe administrimi i procedurave të ankandit publik, si dhe vlerësimi i ofertave në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohen anëtarët e Komisionit që gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të tyre të veprojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

5. Obligohet Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave që, në bashkëpunim me administratën komunale, të zhvillojë procedurat e ankandit publik dhe procesin e vlerësimit të ofertave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Administrata e Komunës i ofron mbështetje administrative dhe profesionale Komisionit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.
7. Kuvendi i Komunës së Kamenicës ruan të drejtën e ndryshimit dhe plotësimit të përbërjes së Komisionit, sipas nevojës.
8. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Komisioni dhe organet përgjegjëse të administratës komunale.
9. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në pajtim me nenin 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Aktëve të Komunave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 24/2024), si dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në faqen zyrtare të Komunës.


Vendimi i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Nënkryetares, Shërbimit të Kuvendit, Drejtorive Komunale, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Anëtarëve të Komisionit, MAPL-së dhe QSHQ – arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 05.06.2026



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministerstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration		
Data: Datum: Date:	08.06.2026	
Tipi i organizimit:	Nr. i llogaritjes:	Vlera:
-V(-)	020-402	



Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d), 14, 17, shkronja a) dhe neni 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), neni 5, neni 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe neni 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 5 paragrafi 1 pika 1.2, neni 6, neni 8 dhe neni 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe neni 3, paragrafi 3.7, neni 5, paragrafi 5.1, shkronja h), neni 38, paragrafi 38.1 dhe neni 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 29.05.2026 miratoi këtë:

VENDIM

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë Vendim miratohet dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës për personat fizikë dhe juridikë dhe zhvillimi i procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër, në kohëzgjatje prej 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, ndodhet në Zonën Kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Qendra Tregtare Zejtare", me shfrytëzim aktual "trual", e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71107041-01981-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 54,260 m² (pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e gjashtëdhjetë metra katrorë), nga e cila jepen në shfrytëzim 650 m² (gjashtëqind e pesëdhjetë metra katrorë), në zonën pranë objektit të Shtëpisë së Kulturës "Isa Kastrati", në pronësi të Komunës së Kamenicës.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, është krijimi dhe zhvillimi i hapësirave për fitnes, sport dhe rekreacion, në funksion të interesit publik dhe përmirësimit të kushteve për aktivitete rekreative dhe sportive, si dhe rritja e vlerës së pronës komunale dhe realizimi i përfitimeve ekonomike nga dhënia e saj me qira.
4. Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër, në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vjetësh.
5. Prona e paluajtshme objekt i këtij vendimi mbetet në pronësi të Komunës së Kamenicës dhe nuk e ndryshon titullarin juridik. Shfrytëzuesi nuk ka të drejtë ta tjetërsojë, ta japë në nën shfrytëzim personave të tretë, ta ngarkojë me barrë tatimore apo me çfarëdo barre tjetër juridike.

6. Çmimi fillestar për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, të cekur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, mbi baza mujore, përcaktohet nga Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave, në përputhje me Rregulloren komunale në fuqi për Taksat, Tarifat Ngarkesa dhe Gjoha Komunale në Komunën e Kamenicës.
7. Obligohen Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, dhe Diasporë, Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, që në bashkëpunim me Komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave, të zhvillojnë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Obligohet Kryetari i Komunës që, pas përfundimit të procedurave të ankandit publik, me kontratë të veçantë të përcaktojë të drejtat dhe obligimet ndërmjet Komunës dhe përfutuesit të së drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale.
9. Procedura për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës realizohet përmes ankandit publik.
10. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në pajtim me nenin 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 24/2024), si dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i përdërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Nënkrjetares, Shërbimit të Kuvendit, Drejtorive Komunale, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, MAPL-së dhe QSHQ – arkiv

Kryesuese e Kuvendit Komunal


Arbnor BEÇIRAJ ETET






Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 05.06.2026



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d) 14, 17, shkronja a) dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 3, paragrafi 3.7, nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja b), nenit 38, paragrafi 38.1 dhe nenit 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 29.05.2026 miratoi këtë:

VENDIM

Për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës

- Me këtë Vendim miratohet dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës për personat fizikë dhe juridikë dhe zhvillimi i procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër, në kohëzgjatje prej 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
- Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekura në pikën 1 të këtij vendimi, ndodhen në Zonën Kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Qendra Tregtare Zejtare", dhe janë të evidentuara sipas certifikatave të pronësisë me numër P-71107041-01339-0 dhe P-71107041-01340-0 në pronësi të Komunës së Kamenicës, me sipërfaqe të përgjithshme prej 7393 m² (shtatë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre metra katrorë), nga të cilat për shfrytëzim jepen 500 m² (pesëqind metra katrorë), në hapësirën e Tregut të Qytetit, pranë objektit të Viva Fresh Store.
- Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës komunale, si dhe sigurimi i të hyrave dhe përfitimeve ekonomike për Komunën nga dhënia e pronës në shfrytëzim me qira.
- Afati për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër, në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjetësh.
- Prona e paluajtshme objekt i këtij vendimi mbetet në pronësi të Komunës së Kamenicës dhe nuk e ndryshon titullarin juridik. Shfrytëzuesi nuk ka të drejtë ta tjetërsojë, ta japë në nën shfrytëzim personave të tretë, ta ngarkojë me barrë tatimore apo me çfarëdo barre tjetër juridike.
- Çmimi fillestar për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, të cekur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, mbi baza vjetore, përcaktohet nga Komisioni për zbatimin e procedurave dhe


vlerësimin e ofertave, në përputhje me Rregulloren komunale në fuqi për Taksat, Tarifat Ngarkesa dhe Gjoha Komunale në Komunën e Kamenicës.

7. Obligohen Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, dhe Diasporë, Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, që në bashkëpunim me Komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave, të zhvillojnë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Obligohet Kryetari i Komunës që, pas përfundimit të procedurave të ankandit publik, me kontratë të veçantë të përcaktojë të drejtat dhe obligimet ndërmjet Komunës dhe përfutësit të së drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale.
9. Procedura për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës realizohet përmes ankandit publik.
10. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në pajtim me nenin 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 24/2024), si dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Nënkyetares, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorive Komunale, MAPL-së dhe QSHQ – arkiv

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Arbore HECARAJFERA





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Kadri Rrahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës Arbnore Beqiraj Fera, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Kamenicës
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erbil Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtim
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Sh.01Nr.15156 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës
I miratuar më datë: 29.05.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08.06.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

ARSYETIM

MAPL, konstaton se Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 ka miratuar Vendimin Sh.01Nr.15156 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës.

MAPL, konstaton se Vendimi Sh.01Nr.15156 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, i cili përcakton se: *"Kryetari i Komunës i propozon për miratim paraprak Kuvendit të Komunës pronën e paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim"*.

Në rastin konkret titulli i Vendimit i cili propozohet për miratim në Kuvend të Komunës duhet të jetë: Vendim paraprak Sh.01.Nr. _____ për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës.

Po ashtu MAPL, konstaton se Vendimi Sh.01Nr.15156 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, për parcelën kadastrale P-71107041-01339-0 dhe parcelën kadastrale P-71107041-01340-0 në pronësi të Komunës së Kamenicës, është në kundërshtim me Listën e veçantë Sh.02Nr.2258 të pronave të paluajtshme komunale për vitin 2026 të Komunës së Kamenicës. Përkatësisht afati i dhënies në vendim është përcaktuar afatshkurtër në kohëzgjatje prej 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite, ndërsa në listën e pronave për parcelat kadastrale P-71107041-01339-0 dhe P-71107041-01340-0 afati i dhënies në shfrytëzim është përcaktuar afatgjatë 15-99 vite.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kamenicës duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Kadri Rrahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës Arbnore Beqiraj Fera, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Kamenicës
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL Datë: 17.06.2026 -VI-020-402
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtim
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Sh.01Nr.15161 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës
I miratuar më datë: 29.05.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08.06.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

ARSYETIM

MAPL, konstaton se Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 ka miratuar Vendimin Sh.01Nr.15161 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës.

MAPL, konstaton se Vendimi Sh.01Nr.15161 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, i cili përcakton se: *"Kryetari i Komunës i propozon për miratim paraparak Kuvendit të Komunës pronën e paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim"*.

Në rastin konkret titulli i Vendimit i cili propozohet për miratim në Kuvend të Komunës duhet të jetë: Vendim paraparak Sh.01.Nr._____ për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës.

Po ashtu MAPL, konstaton se Vendimi Sh.01Nr.15161 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, për parcelën kadastrale P-71107041-01981-1, është në kundërshtim me Listën e veçantë Sh.02Nr.2258 të pronave të paluajtshme komunale për vitin 2026 të Komunës së Kamenicës. Përkatësisht afati i dhënies në vendim është përcaktuar afatshkurtër në kohëzgjatje prej 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite, ndërsa në listën e pronave për parcelën kadastrale P-71107041-01981-1 afati i dhënies në shfrytëzim është përcaktuar afatgjatë 15-99 vite.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kamenicës duhet të ndërmer veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Kadri Rrahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës Arbnore Beqiraj Fera, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Kamenicës
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtim
Lloji i aktit:	Vendim

Datë: 18.06.2026
-VI-020-402

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Sh.01Nr.15152 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës
I miratuar më datë: 29.05.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08.06.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

ARSYETIM

MAPL, konstaton se Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 ka miratuar Vendimin Sh.01Nr.15152 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

MAPL, konstaton se Vendimi Sh.01Nr.15152 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, është në kundërshtim me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ku përcaktohet se: *"Për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, formohet Komisioni Vlerësues në përbërje prej pesë (5) anëtarëve"*, dhe *"Kryetari i Komunës i propozon dy (2) anëtarë nga ekzekutivi i komunës, Kuvendi i Komunës propozon dy (2) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga radhët e subjekteve të ndryshme politike dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar, i cili propozohet nga sektori jo qeveritar lokal"*.

Po ashtu është në kundërshtim me nenin 2 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, i cili përcakton se:

"Komisioni vlerësues themelohet në përbërje prej pesë (5) anëtarë: Kryetari i Komunës i propozon dy (2) anëtarë nga ekzekutivi i komunës, Kuvendi i Komunës propozon dy (2) anëtarë nga kuvendi i komunës nga radhët e subjekteve të ndryshme politike, dhe sektori jo qeveritar lokal propozon një (1) anëtar, sipas thirrjes për propozime të shpallur nga komuna".

Në rastin konkret komisioni i formuar për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës me Vendimin Sh.01Nr.15152, përbëhet nga gjashtë (6) anëtarë.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kamenicës duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Kadri Rrahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës Arbnore Beqiraj Fera, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Kamenicës
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erbilin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtim
Lloji i aktit:	Vendim

Datë: 18.06.2026
-VI-020-402

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Sh.01Nr.15160 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

I miratuar më datë: 29.05.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08.06.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

ARSYETIM

MAPL, konstaton se Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2026 ka miratuar Vendimin Sh.01Nr.15160 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

MAPL, konstaton se Vendimi Sh.01Nr.15160 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, është në kundërshtim me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ku përcaktohet se: *"Për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, formohet Komisioni Vlerësues në përbërje prej pesë (5) anëtarëve"*, dhe

"Kryetari i Komunës i propozon dy (2) anëtarë nga ekzekutivi i komunës, Kuvendi i Komunës propozon dy (2) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga radhët e subjekteve të ndryshme politike dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar, i cili propozohet nga sektori jo qeveritar lokal".

Po ashtu është në kundërshtim me nenin 2 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, i cili përcakton se:

"Komisioni vlerësues themelohet në përbërje prej pesë (5) anëtarë: Kryetari i Komunës i propozon dy (2) anëtarë nga ekzekutivi i komunës, Kuvendi i Komunës propozon dy (2) anëtarë nga kuvendi i komunës nga radhët e subjekteve të ndryshme politike, dhe sektori jo qeveritar lokal propozon një (1) anëtar, sipas thirrjes për propozime të shpallur nga komuna".

Në rastin konkret komisioni i formuar për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës me Vendimin Sh.01Nr.15160, përbëhet nga gjashtë (6) anëtarë.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kamenicës duhet të ndërmerri veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislationin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme lidhur me këtë vlerësim.